

## GJYKATA E QARKUT PRIZREN

Ap. 156/10

07 dhjetor 2010

### NË EMËR TË POPULLIT

Trupi gjykues i Gjykatës së Qarkut Prizren, i përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it, Ingo Risch, si kryetar i trupit gjykues, Gjyqtari i EULEX-it Gunnar Oyhaugen dhe gjyqtarja vendore Raima Elezi, si anëtarë të trupit gjykues, të ndihmuar nga Labinot Jetishi si proces-mbajtës, në lëndën penale kundër:

E.A , emri i babait , emri i nënës (e gjinisë ,  
lindur më , në , Komuna e ;  
tashmë banues në , i etnisë shqiptare, jurist dhe  
punonjës në dy kompani, i martuar, babai i katër fëmijëve, gjendja ekonomike e  
mesme, numri i letërnjoftimit .

#### *I akuzuar*

Sipas Aktakuzës PP nr. 524/09, të ushtruar më 03 gusht 2009, me veprën penale të nxjerrjes së vendimeve gjyqësore të paligjshme, në shkelje të Nenit 346 të Kodit Penal të Kosovës (këtej e tutje KPK),

#### *sic përshkruhet më poshtë:*

Më 04 qershor 2008, i pandehuri duke vepruar si Gjyqtar në Gjykatën e Qarkut Prishtinë, me synimin për të siguruar një përfitim pasuror për një person tjetër, duke i shkaktuar dëm një pale të tretë, nxori një vendim gjyqësor të paligjshëm, përkatësisht Aktvendimin 547/2008, datë 04 qershor 2008. Pas marrjes së shkresave të lëndës së trashëgimisë nëpërmjet një ankese, i pandehuri nxori një vendim të paligjshëm ku vendosi në lidhje me ankesën bazuar në një Aktvendim përfundimtar kinse të lëshuar nga Gjykata Komunale e Prishtinës, T. nr. 136/2002, datë 14 tetor 2002; u mendua se Aktvendimi ishte nxjerrë nga Gjyqtari Z.S , i cili nuk ishte përzgjedhur në bazë të dispozitave të UNMIK-ut, nga Përfaqësuesi Special i Kombeve të Bashkuara. Aktvendimi vërtetohej me një vulë qarkore brenda së cilës shkruhej *Republika e Serbisë, Provinca Autonome e Kosovës dhe Metohisë, Gjykata Komunale e Prishtinës*, organ paralel gjykatë.

#### *Duke vendosur në lidhje me:*

- 1) ankesën e Prokurorisë Publike Komunale në Prizren, datë 05.11.2010, dhe

2) përgjigjen në ankesë të mbrojtësit të të pandehurit  
avokatit Hamit Gashi

*të paraqitur kundër:*

Aktgjykimin të Gjykatës Komonale të Prizrenit, P nr. 917/10, datë 7 tetor 2010

*Në bazë të*

Nenit 423 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (këtej e tutje  
KPPK) shqipton këtë:

## **AKTGJYKIM**

Ankesa e Prokurorisë Komonale në Prizren **HIDHET POSHTË SI E  
PABAZUAR** dhe, për rrjedhojë, Aktgjykimi i Gjykatës Komonale të Prizrenit  
P nr. 917/10, datë 7 tetor 2010, **KONFIRMOHET**.

## **ARSYETIM**

### **1. Sfondi procedural**

Më 10 nëntor 2008, Prokuroria Publike Komonale e Prizrenit mori aktvendim  
për nisjen e hetimeve, PP nr. 5105-15/2008, kundër **B.L** dhe  
**S.N**, për dyshim të arsyeshëm se ata kishin kryer veprën penale  
të nxjerrjes së vendimeve gjyqësore të paligjshme, në shkelje të nenit 346 të  
KPK-së.

Të nesërmen, Prokurori Publik Komunal filloi hetimet kundër **E.A**  
për të njëjtin dyshim (PP nr. 5105-15/2008).

Më 22 janar 2009, Prokurori Publik nxori Aktvendimin për ndërprerjen e  
hetimit kundër **B.L** dhe **S.N**.

Më 03 gusht 2009, Prokurori Komunal i Prizrenit ushtroi Aktakuzën PP nr.  
524/09, datë 30 korrik 2009, kundër **E.A**; me akuzën e veprës  
penale të nxjerrjes së vendimeve gjyqësore të paligjshme. Prokurori nuk tregoi  
ndonjë palë të dëmtuar në këtë lëndë. Akuza kundër të pandehurit nuk  
përbante ndonjë të dhënë për persona të dëmtuar.

Më 15 shtator 2009 u mbajt seanca e konfirmimit të aktakuzës nga një gjyqtar kosovar. Me propozim të Mbrojtësit, seanca u shty.

Të njëjtën ditë Mbrojtësi ushtroi kërkesë për përjashtimin e Prokurorit Publik kosovar të lëndës dhe kërkoi që lëndën ta marrin për shqyrtim prokurori dhe gjyqtarët e EULEX-it.

Më 28 tetor 2009, një seancë tjetër konfirmimi të aktakuzës u zhvillua nga Gjykata Komunale e Prizrenit. Mbrojtësi kërkoi që Prokurori Publik ta rishikonte aktakuzën. Më tej ai përmendi kërkesën drejtuar gjyqtarëve të EULEX-it. Gjyqtari i konfirmimit të aktakuzës e pranoi kërkesën e Mbrojtësit dhe e shtyu seancën për një datë të pacaktuar.

Lënda iu caktua gjyqtarëve të EULEX-it në vijim të një seancë të mbajtur në Gjykatën Komunale të Prizrenit më 21 janar 2010.

Më 26 shkurt 2010, seanca e konfirmimit të aktakuzës, e organizuar nga një gjyqtar i EULEX-it, u shty për shkak të mungesës së Prokurorit Publik Komunal.

Seanca tjetër e konfirmimit të aktakuzës u zhvillua në Gjykatën Komunale të Prizrenit më 2 mars 2010. Gjyqtari i EULEX-it për konfirmimin e aktakuzës, me Aktvendimin KA nr. 116/09, e rrëzoi aktakuzën PP nr. 524/09, në bazë të nenit 316, paragrafi 1, pika 4 të KPPK-së. Prokurori pranoi se nuk e kishte përmendur palën e dëmtuar në aktakuzë. Për më tepër, ai deklaroi shprehimisht se dëmi i ishte shkaktuar Republikës së Kosovës.

Më 10 mars 2010 Prokurori Publik Komunal ushtroi ankesë kundër aktvendimit të rrëzimit të aktakuzës. Më 15 prill 2010 një trup gjykues i përbërë me shumicë gjyqtarësh të EULEX-it e pranoi ankesën dhe konfirmoi aktakuzën (Aktvendimi KP nr. 26/10).

Më 1 korrik 2010, me Aktvendimin PKL-KZZ 47/10, Gjykata Supreme e Kosovës e rrëzoi si të papranueshme kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të ushtruar nga Mbrojtësi kundër Aktvendimit konfirmues të datës 15 prill 2010.

Më 7 tetor 2010 Gjykata Komunale e Prizrenit në lëndën P nr. 917/10 mori Aktgjykim me të cilin i pandehuri, E.A., me shënimet personale të cekura më lart, shpallet JO FAJTOR për veprën penale të përshkruar më lart.

Më 05.11.2010 Prokurori Komunal ushtroi ankesë kundër Aktgjykimit të shqiptuar nga Gjykata Komunale në Prizren, P. nr. 917/10, datë 07.10.2010.

## **2. Konstatimet e Gjykatës**

Pavarësisht nëse vendimi në fjalë i nxjerrë nga i akuzuari, i cili solli aktakuzën, ishte i drejtë apo i gabuar, nëse ishte i ligjshëm apo i paligjshëm, trupit gjykues i mungon elementi tjetër i nenit 346 të KPK-së, që kërkon qëllimin për t'i shkaktuar dëm një pale, ose për të siguruar një përfitim për veten apo për dikë tjetër. Nuk ka tregues dhe nuk ka prova se i akuzuari vendosi në lëndën civile

në fjalë me një qëllim të tillë. Po kështu, në shkresat e lëndës nuk ka të dhëna, as në ankesën e Prokurorit Publik nuk ka tregues se i pandehuri kishte ndonjë lidhje a marrëdhënie me ndonjërin nga palët. Së fundi, nuk ka as dyshim se i pandehuri vendosi në mënyrë armiqësore lidhur me palën në dëm të së cilës u mor vendimi.

Për këto arsye, trupi gjykues është i bindur se kërkesat nën nenin 346 nuk janë përmbushur, me rezultatën që ankesa duhet të hidhet poshtë dhe të mbetet në fuqi lirimi nga akuza.

**GJYKATA E QARKUT PRIZREN**  
**Ap. 156/10 Datë 07.12.2010**

Proces-mbajtës


Anëtarë të trupit gjykues

Kryetar i trupit gjykues

\_\_\_\_\_  
Labinot Jetishi

\_\_\_\_\_  
Gunnar Oyhaugen

\_\_\_\_\_  
Ingo Risch



Republika Kosovës  
Republika Kosovo  
Kosova GUMHURLYE  
KOSOVËSINË E KOPJËS E VËRTETON  
ТАЧНОСТ ОТПРАВКА ПОТВРЂУЈЕ  
BU KOPYAHIN ASLMA UYGUN OLDUGU TASDIK EDIR

Punëtor i autorizuar  
Gjykatari teknik  
Y. Elezi